



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:265502
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05747879

K.DH.SH.II.nr.409/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” SH.A., - KESCO, me NUI: 810547549, me seli në Bulevardin Bill Kllinton nr. 5, në Prishtinë, kundër debitorit N.SH. VLLEZRIT BERISHA B.B., me seli në rr. “Ahmet Krasniqi”, Lagja Arbëria 3, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florim SHefqeti, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 659/23 të datës 27.11.2023, me datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” SH.A., - KESCO, me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 659/23 të datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. KPPP.nr. 659/23 të datës 27.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.SH. VLLEZRIT BERISHA B.B., me seli në rr. “Ahmet Krasniqi”, Lagja Arbëria 3, në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 68/23, i lejuar më datë 24.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Eset Murati, Anullohet dhe Përfundohet procedura në tërësi si dhe Detryohet kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 156.00 € (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka kërkuar që ta refuzoj ankesën e kreditorit, dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr. 659/23 të datës 27.11.2023.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, P.nr. 68/23 të datës 24.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist - DPR-90088597 duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh, prej datës së pranimi të këtij vendimi të paguaj borxhin në shumën prej 1,498.64 € për konsumin e energjisë elektrike të krijuar nga data

01.09.2022 deri me datën 16.02.2023, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit së bashku me shpenzimet e ekzekutimit, në llogarinë bankare të kreditorit, në të kundërtën realizimi i përmbarimit të bëhet me ndalimin e mjeteve në para nga llogaritë rrjedhëse të debitorit dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, ndalimin e mjeteve në të ardhurat personale ose me regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit, deri në përmbushjen e borxhit të kërkuar nga kreditori. Kundër urdhrin përmbarimor Debitori në përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor duke kundërshtuar se urdhri përmbarimor i lëshuar nga përmbaruesi privat është i pabazuar, ngase debitori i ka kryer të gjitha obligimet e tij dhe se qëllimi i kreditorit është përfitimi i kundërligjshëm duke dëmtuar debitorin duke bashkëngjitur si provë fletëpagesën e datës 28.03.2023. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të refuzohet urdhri përmbarimor, si dhe të detyrohet kreditori që t'i mbulojë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet e përpilimit të prapësimit nga ana e avokatit në shumën prej 208.00 € konform Tarifës së Odës së Avokatëve

Përgjigje në prapësim nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.68/23 i datës 24.03.2023 duhet të anulohet, pasi që në bazë të provave që gjenden në shkresa të lëndës, përkatësisht në bazë të Urdhërpagesës së datës 28.03.2023, nr. transaksioni të NLB Bank, vërtetohet fakti se debitori ka përmbushur në tërësi detyrimin e tij në shumën prej 1,498.64 €, ndaj kreditorit në emër të borxhit për faturat e papaguara për numrin unik të konsumatorit DPR – 90088597 dhe këtë përmbushje e ka bërë ende pa u njoftuar për procedurën përmbarimore të iniciuar nga kreditori, kjo pasi që debitori ka rënë në dijeni për urdhrin përmbarimor me datë 07.04.2023, kur edhe e ka pranuar të njëjtin.

Andaj shkalla e parë duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: “dokumenti në bazë të cilit është marr

vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik” vendosi si në dispozitivi të këtij aktvendimi pasi që ekstrakti nga librat afarist në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor, tanimë e ka humbur efektin juridik.

Prandaj vendimin mbi përfundimin e procedurës përbarimore Gjykata e mbështeti në nenin 66 par. 4 të LPP-së i cili përcakton se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se si dokument i besueshëm – fatura e konsumatorit DPR-.... e pa paguar e në shumën prej 1,498364 €, vërtetohet fakti se debitori ka përmbushur në tërësi detyrimin e tij në tërësi ndaj kreditorit dhe këtë përmbushje e ka bërë ende pa u njoftuar për urdhrin përbarimor P.nr.68/23 të datës 24.03.2023, dhe se kjo gjykatë vendimin mbi përfundimin e procedurës përbarimore e mbështet në nenin 66 par. 4 të LPP-së.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë

çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarimor që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.409/24, me datë 29.05.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti